



Ftesë në Tryezën e Diskutimit

“Fuqizimi i Rolit Mbikqyrës të Legjislativit në Vlerësimin e Hapësirave për Korrupsion”

Fondacioni Westminster për Demokraci në bashkëpunim me Qendrën Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER) kanë kënaqësinë t’ju ftojnë në tryezën e diskutimit: **“Fuqizimi i Rolit Mbikqyrës të Legjislativit në Vlerësimin e Hapësirave për Korrupsion”**, që do të zhvillohet në datë 11 Korrik 2023, ora 11:00 - 12:35, në Hotel Rogner.

Aktiviteti vjen në kuadër të projektit: **“Rritja e Llogaridhënies së Qeverisë përmes një Parlamenti më Reagues”**, financuar nga Ambasada Britanike në Tiranë.

Kjo tryezë synon të sjellë së bashku politikë-bërës, akademikë, përfaqësues të medias dhe shoqërisë civile, për të diskutuar drejtimet e mundshme të përmirësimit të veprimtarisë së Legjislativit shqiptar në vlerësimin e hapësirave ligjore për korrupsion dhe për të identifikuar ndërhyrjet eventuale në aktet rregullatore të institucionit për mbylljen e shtigjeve të këtij fenomeni në procesin legjislativ.

Pjesëmarrësit do të eksplorojnë përvojën e derisotme të vendeve të OECD-së, rajonit, dhe të Shqipërisë, si dhe do të prezantohen dy rastet studimore për draft ligjet për Prokurimin Publik dhe Rikuperimi i Aseteve.

Roli i shoqërisë civile është shumë i rëndësishëm për të ofruar gjetje dhe rekomandimet specifike për të zgjeruar ekspertizën/profesionalizmin, transparencën e procesit të konsultimin publik të akteve ligjore të Qeverisë dhe të nismave të Legjislativit.



AGJENDA

E Martë, 11 Korrik 2023, 11:00-12:35

@ Hotel Rogner

10:45-11:00 Regjistrimi i Pjesëmarrësve

11:00-11:10 Fjalët hapëse

- *Z. Sokol Haxhiu, Drejtor i Fondacionit Westminster për Demokraci*
- *Z. Zef Preçi, Drejtor Qendrës Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER)*
- *Përfaqësuesi i Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë (tbc)*

11:10-11:30 Rreth praktikave të mira të vendeve të OECD, rajonit dhe të Shqipërisë për mbikqyrjen parlamentare në ngushtimin e hapësirave për korrupsion - aspekte metodike.

- *OECD, Z. Ilir Ciko, ACER*
- *Rajoni dhe Shqipëria, Z. Zef Preçi, ACER*

11:30-11:50 Forcimi i rolit mbikqyrës të legjislativit në ngushtimin e hapësirave Për korrupsion–rasti studimor i prokurimit publik dhe rikuperimit të aseteve - gjetjet dhe rekomandime

- *Prokurimet Publike dhe Rikuperimi i Aseteve - Znj. Blerte Kraja & Znj. Brunilda Kosta, ACER*

11:50-12:15 Drejtime të përmirësimit të rolit mbikqyrës të legjislativit në vlerësimin e hapësirave për korrupsion në legjislacionin shqiptar

- *Znj. Jorida Tabaku, Kryetare e Komisionit të Integritetit Europian, PD*
- *Znj. Blerina Gjylameti, Sekretare e Komisionit për Ekonomi dhe Financë, PS*
- *Zj. Petrit Vasili, Deputet në Kuvendin e Shqipërisë, PL*

12:15-12:30 Pyetje dhe Diskutime

12:30-12:35 Fjala Përmblylëse